

P.nr.1579/2016

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e praktikantes Hata Çoçaj procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1295-4/2016 të datës 21.07.2016 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e prokurorit të shtetit Besim Susuri dhe të akuzuarit, me datë 06.11.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari:

A. B. nga i ati R. dhe e ëma R. e lindur K., i lindur me datë në fshatin B. Komuna e Dragashit, tani me banim në Prizren në rrugën nr. ka të kryer shkollën fillore, moler, i martuar, baba i dy fëmijëve, identifikimi i të njëjtit bëhet nëpërmjet kartelës së identifikimit me numër personal, shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

PËR SHKAK

Me datën 01.05.2016 rreth orës 12:00, në Prizren në rrugën “”, në bashkëveprim me të miturin A. B., i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e akuzuarit B. S., në atë mënyrë që pas rrahjes së nipit të tij të mitur A. B. nga ana e akuzuarit B. S., momentin kurrë njoftohet për arsyen e rrahjes, së bashku me të miturin shkon për tu takuar dhe përsëri fillon konflikti verbal mes tyre e më pastaj të njëjtin e godasin në pjesë të ndryshme të trupit, me ç rast i shkaktojnë lëndime trupore dhe atë: ndrydhje në regjionin e qafës dhe supit të majte, ndrydhje në gishtat e dorës së majte dhe gërvishtje në gishtin e pestë të dorës, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.


Këso dore në bashkëkryerje ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 85, 86, 73 dhe nenit 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK i shqipton:

VËREJTJE GJYQSORË

I akuzuari A. B., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK, e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, i njëjti nëse sërish kryen vepra të tilla do të dënohet me dënim më të rëndë.

I akuzuari B. (B. S.) nga Prizren rruga “” nr. në cilësinë e dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.



Obligohet i akuzuari të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të ekspertizës për ekspertin e mjekësisë ligjore shumën prej 10 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1295-4/2016 të datës 21.07.2016, ushtruar kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK.


Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar në numrin PP/II.nr.1295-4/2016 të datës 21.07.2016, kundër të akuzuarit A. B., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK. Sepse gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë është vërtetuar në tërësi nga deklarata e akuzuarit i cili e pranon fajësinë, po ashtu dhe në bazë të provave materiale të cilat janë bashkangjitur aktakuzës. Andaj propozoi gjykatës që i njëjtit të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari A. B. deklaroi se ditën kritike pas marrjes në informatës për sulmin fizik të nipit të tij të miturit A. B. dhe për lëndimet e pësura ka reaguar në mënyrë të kundërligjshme, me ç' rast edhe ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të akuzuarit B. S. Këtë veprim ka ndërmarrë i akuzuari pasi që ka qenë në gjendje të tensionuar sepse paraprakisht është irrituar nga i akuzuari B. S., me ç' rast edhe ka ardhur deri tek pasoja. Andaj nga gjykata kërkoi që të shqiptoj një dënim sa më të butë pasi që është kryefamiljar, mbajtës i vetëm i familjes, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe premtoj para gjykatës se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me atë 01.05.2016 në mesditë rreth orës 12:00, në Prizren në rrugën '...', për shkak të mosmarrëveshjes që kishte me të akuzuarin B. S., për shkak të rrahjes së nipit të tij i mituri A. B., i akuzuari A. B. pas takimit fillimisht fillon konflikti verbal midis tyre e pastaj bashkë me të miturin e godasin në pjesë të ndryshme të trupit të akuzuarin B. S., me ç' rast me këto veprime i shkaktën lëndime të lehta trupore, ndrydhje në regjionin e qafës dhe supin e majte, ndrydhje në gishtat e dorës së majte dhe gërvishtje në gishtin e pestë të dorës, të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e tij të përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajësisë është mbështetur në fakte që përmban aktakuzën me ç' rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Po ashtu gjykata ka ardhur në



përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe se në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, është i gjendjes së varfër ekonomike. Andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe veprën e kryer i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse konsideron se me qortim do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se vërejtja gjyqësore e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i qortimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.


Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 498 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1579/2016 të datës 06.11.2017

Praktikantja
Hata Çoçaj



Gjyqtarja
Teuta Krusha



UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.